REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 6217/1 Prot. Maliq më, 18/11/2026

Lënda: Informacionin mbi kontratat e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor

KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

Z. Yllson Ibrahimllari

Adresa: Fshati Velçan, Nj.A. Gorë, Maliq

Të nderuar!

Në përgjigje të kërkesave protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 6217 prot datë 26.10.2026 nga Grupi i Këshilltarëve të Opozitës dhe kërkesës nr. 6216 prot datë 26.10.2026 nga Z. Yllson Ibrahimllari, në të cilën kërkohet një informacion mbi kontratat e qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq me subjektet e Hec-eve që shtrihen në territorin e Bashkisë Maliq ju informojmë si më poshtë:

I- Bashkia Maliq përfiton taksa dhe tarifa nga të gjithë Hec-et për të cilët është dhënë leje dhe kontratë koncensionare nga Ministria e Energjitikës për ushtrimin e aktivitetit të ndërtimit dhe operimit të objekteve Hec për prodhimin e energjisë elektrike sipas bazës ligjore të mëposhtëme:

1- **Ligjit 57/2020 "Për Pyjet",**
   - **Neni 25** "*Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar*" - **Pika 1**. "Pjesë të fondit pyjor publik jepen në përdorim për zhvillimin e veprimtarive për:
     - **c)** shtrimin e rrjeteve/linjave, tubacioneve dhe ndërtime infrastrukturore të tjera të përkohshme ose të përhershme;
     - **ç)** nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit.

2- **Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016** "*Për rregullat,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik*",
   - **Pika 22** "*Bëjnë përjashtim nga konkurrimi publik dhënia e sipërfaqeve në përdorim rastet kur persona fizikë/juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me*:
     b) *procedurat në zbatim të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për koncensionet*";

f) *procedurat në zbatim të ligjit për ndërtim të veprave hidroteknike (për shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh për HEC-e;*"

këto aktivitete nuk miratohen nga Bashkia por nga Ministria përkatëse e linjës, me formimin e strukturës së pyjeve dhe kullotave në Bashki mbas transferimit të fondit pyjor dhe kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq në vitin 2016 vazhdoj procedurat ligjore për vjeljen e detyrimeve si taksa dhe tarifa të sipërfaqeve që përdoreshin nga këto subjekte për të cilat me ndryshimin e pronësisë së këtyre ngastrave pyjore/kullosore nga Ministria e Mjedisit dhe Ish Drejtorive të Shërbimit Pyjor drejt Bashkisë, u vazhdua rilidhja e kontratave të qirasë me Bashkinë Maliq për vjeljen e tarifave të dhënies në përdorim.

Ju bëjmë me dije se për fondin pyjor në Bashkinë Maliq nuk ka pasur miratime dhe kontrata konçensionare të reja nga Ministria e Energjitikës dhe rrjedhimisht nuk ka pasur kontrata të reja qiraje me objekt Hec.
Bashkia Maliq ka bërë rinovimin e Kontratave ekzistuese të dhënies në përdorim të sipërfaqeve që prekin fond pyjor/kullosor në pronësi, si dhe vjeljen e tarifave sipas detyrimit ligjor të tarifave të përcaktuara në **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022** "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre*".

Në lidhje me proçedurën për heqien nga fondi pyjor/kullosor sipas Vendimit të Këshillit të Ministravë nr. 888, datë 27.12.2022 "*Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre*", ju informojmë se shqyrtohet dhe miratohet nga Ministria e Mjedisit dhe nuk ka patur heqje nga fondit pyjor/kullosor për objektet e Hec-eve.

Për kontratat e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq bazuar në **VKM Nr.559, datë 29.07.2022** "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre*", të cilat që prej periudhës së ndërtimit i ka përfunduar afati 10 vjeçar i dhënies në përdorim i cili është afati maksimal i dhënies në përdorim për shkak të ndryshimeve në legjetacion dhe rritjes vjetore të bimësisë pyjore dhe jo pyjore dhe kthimit të sipërfaqeve në gjendje natyrale.

Nga sektori i pyjeve dhe kullotave është bërë vlerësim për evidentimin e sipërfaqeve që kalojnë në fond pyjor të Bashkisë Maliq dhe për shkak të natyrës së ndërtimit të këtyre objekteve siç janë kanalet për të cilat nuk ka mundësi për instalimin e vegjetacionit dhe bimësisë pyjore edhe mbas 10 viteve pasi janë objekte betoni apo mur guri dhe për shkak të vazhdimit të lejave dhe afatit të kontratave konçensionare ekzistuese të këtyre Hec-eve dhe vazhdimit të përdorimit të këtyre

kanaleve nga këto aktivitete të miratuar nga Ministria e Energjitikës, është vazhduar me rilidhjen e kontratave të dhënies në përdorim për objektet kanal për arsye të vjeljes së tarifës përkatëse për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor nga Bashkia Maliq.

Vazhdimi dhe rilidhja e këtyre kontratave përsa i përket sipërfaqeve të ngastrave pyjore që preken ju informojmë se këto kontrata janë lidhur duke u bazuar mbi regjistrimin fillestar të fondit pyjor/kullosor të pronave pyje/kullota të kryer nga Ministria e Mjedisit mbas transferimit të pyjeve me listë inventari, Planeve të reja të Menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të miratuar nga Ministria e Mjedisit me Urdhër Ministri nr.299 datë 04.10.2022 "*Për Miratimin e Planeve të Mbarështimit të Ekonomive Pyjore në Bashkinë Maliq*" si dhe sistemit të ri të informacionit të pyjeve "ALFIS". Tarifat janë bazuar mbi vendimin e ri të Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre*".

Për shkak të ndryshimit të sipërfaqeve dhe konfigurimit hartografik të këtyre ngastrave mbas regjistrimit fillestar dhe publikimit në sistemin ALFIS dhe ndryshimeve në lidhje me përbërjen, dendësinë, madhësinë, volumin dhe habitatet e ngastrave pyjore sipas gjendjes faktike të pasqyruar në planet e reja të menaxhimit, për rilidhjen e këtyre kontratave u bë verifikim në terren, në Planet e Menaxhimit dhe në ALFIS, i gjurmës së kanaleve për të bërë pasqyrimin faktik të shtrirjes së këtyre sipërfaqeve.
Bashkëngjitur po ju vëmë në dispozicion kopje të kontratave aktive të dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor duke ju informuar në vazhdimësi edhe për kontratat të cilat aktualisht janë në proces verifikimi dhe vlerësimi për rilidhjen e tyre.
Për tu dhënë një pasqyrë më të qartë të gjendjes së kontratave aktive dhe kontratave që janë në proces rilidhje dhe vlera e të ardhurave nga tarifat përkatëse që Bashkia Maliq arkëton nga përdorimi i fondit pyjor në pronësi të Bashkisë nga këto aktivitete më poshtë gjeni një tabelë përmbledhëse ku janë pasqyruar të përmbledhura këto kontrata.

Kontrata qiraje në fondin pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq me status aktive, rilidhur dhe në proces rilidhje.

Nr.	Emri i subjektit	Lloji i Aktivitetit	Nr. Kontrate	Statusi	Objekti i kontratës	Të ardhura (lek/vit)
1	**The Blue Star shpk**	HEC	Nr. 3812 Rep, nr.2557 Kol, dt. 13.06.2017	Aktive	Tubacion/Kanal	441850
2	**ABV- Konstruksion shpk**	HEC	Nr. 2003/1 Prot, dt. 19.12.2024	Aktive	Kanal	60900
3	**Energjia Valamara**	HEC	Nr. 4904rep 3873kol dt. 21.10.2026	Aktive	Tubacion/Kanal/Rrugë lidhëse	162750
4	**Energjia Valamara**	HEC	Nr. 3439 Rep, nr.2421 Kol, dt. 19.06.2018	Aktive	Tubacion/Kanal	1178940
5	**Strelca Energji**	HEC	nr. 6251 prot date 20.11.2025	Aktive	Kanal	731300
6	**Xhengo Energji**	HEC	Nr. 3142 Prot. datë 08.07.2016	Përfunduar. Është në proces rilidhje kontrate		
7	**Mp-Hec**	HEC	Nr. 9669 Rep, nr.5663 Kol, dt. 12.12.2016	Perfunduar. Është në proces rilidhje kontrate		
8	**Hydropoëer Plant of Korca**	HEC	nr. 5351 prot date 07.10.2025	Aktive	Kanal	616300
	Total					**3192040**

II- Përsa i përket ndryshimit të hartës së Planit të menaxhimit Mesmal mbi paraqitjen e gjurmës së lumit në hartën fizike të Planit të Menaxhimit Mesmal ju informojmë se:

Ministria e Mjedisit me shkresë nr. 354 prot, datë 10.10.2025 ka kthyer përgjigje e cila bën me dije se mbas verifikimit në terren të gjurmës së lumit i është drejtuar kompanisë ABCONS për të marrë formatin origjinal të hartave dhe me anë të dy studiove që kanë ekspertizë në fushën e Sistemit Gjeografik të Informacionit ka bërë ndryshimet përkatëse dhe këto harta i ka dërguar bashkëngjitur kësaj shkrese.

Bashkia Maliq me marrjen e shkresës nr. 354 prot datë 10.10.2025 nga Ministria e Mjedisit dhe hartat bashkëngjitur kësaj shkrese ka përgatitur projekt vendimin për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 37, datë 28.05.2021 për miratimin e një ndryshimi në sistemin ALFIS të ekonomisë pyjore Mesmal. Nga Këshilli Bashkiak është miratuar ndryshimi i gjurmës së lumit sipas hartave të dërguara nga Ministria e Mjedisit me Vendim nr. 131 datë 31.10.2025 dhe është konfirmuar bazueshmëria ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 1041/1 prot, datë 18.11.2025.

Në zbatim të shkresës nga Ministria e Mjedisit nr. 354 prot datë 10.10.2025 ku thuhet se *në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të pyjeve të kryejë ndryshimin në sistemin ALFIS dhe të bashkëlidhin fragmentin e korrigjuar në hartat e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore mesmal*, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave një kopje të hartave të korrigjuara së bashku me vendimin e Këshillit Bashkiak e ka bashkëlidhur me hartën e planit të menaxhimit sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe siç është kërkuar nga Ministria e Mjedisit një kopje të këtij dokumentacionit të dërguar së bashku me vendimin e Këshillit Bashkiak i është dërguar Agjencisë Kombëtare të Pyjeve me shkresë nr. 3153/2 prot datë 24.12.2025.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve me shkresë nr. 135 prot datë 28.01.2026 ka kthyer përgjigje ku nuk e ka mare parasysh këtë proçedurë dhe ka kërkuar rishikim apo përditësim të planit të menaxhimit sepse këto veprime të kryera në planin e menaxhimit për ndryshimin e pasqyrimit të lumit sjellin ndryshime në gjendjen e fondit pyjor, përfshirë treguesit silvoteknikë, pronësinë, administrimin dhe kategorinë e përdorimit të tokës dhe në zbatim të ligjit nr. 57/2020 për pyjet neni 11 proçedura e rishikimit të Planit të Mbarështimit ndjek të njëjtin proces miratimi si hartimi i planit të ri por Agjencia Kombëtare e Pyjeve në përgjigjen e saj nuk e ka bërë të qartë si është verifikuar se ky ndryshim sjell dhe ndryshime të tjera të cilat kërkojnë rishikim të Planit të Menaxhimit.

Bashkia Maliq përgjigjen e marrë nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve me shkres nr.135 prot datë 28.01.2026 ja ka përcjellë me shkresë nr. 746 prot datë 10.02.2026 Ministrisë së Mjedisit, në të cilën e ka vënë Ministrinë në dijeni mbi përgjigjen e ardhur nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve gjithashtu duke mare parasysh se këto harta u përgatitën nga Ministria e Mjedisit me anë të dy studiove të specializuara i është kërkuar dërgimi i hartave të gjurmës së lumit Velçan, të nënshkruara dhe vulosura duke pasqyruar në këto harta edhe ndryshime kufijsh nëse ka.

Ministria e Mjedisit ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 908/1 prot datë 05.03.2026 ku është shprehur se:

> *"Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 746 prot datë 10.02.2026 "Kthim përgjigje", drejtuar Ministrisë së Mjedisit, ju bëjmë me dije se: sipas shkronjës (c), pika 3, e nenit 11, të ligjit 57/2020 "Për pyjet" planet e mbarështimit për pyjet rishikohen apo përditësohen, sipas nevojës, nga strukturat përgjegjëse të parashikuara në këtë ligj dhe ndjekin të njëjtin proces si plan i ri mbarështimi."*

por deri më sot nga Ministria e Mjedisit nuk janë dërguar harta apo informacion nga këto studio nëse ndryshimi i lumit në harta e Planit të Menaxhimit sjell ndryshime të tjera të përmendura nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve për të kryer rishikim të Planit të Menaxhimit apo ky ndryshim nuk sjell ndryshime të tjera.

Bashkëngjitur gjeni dhe dokumentacionin përkatës të kësaj proçedure me vendimin e këshillit Bashkiak dhe korrespondencën e ndjekur.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

Nr tel. 069 3340 606 (Edi inthini

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
NR. 3812 REP
NR. 2557 KOL

REPUBLIKA E SHQIPERISE DENADA K. KODRA NOTER KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

KONTRATE QIRAJE
PER
DHENIEN NE PERDORIM TE FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBETAR

Sot, në datën 13.06.2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), ditën e hënë, u paraqitën personalisht para meje Noteres Denada Kodra, Zyrës se Noterise të ndodhur në Qytetin e Korçës, palët e poshtëshënuara, për te lidhur këtë kontratë

Baza Ligjore e Kontartes : Ligji Nr. 139/2015 "Për vëtëqeverisjen vendore", neni 19 të ligjit Nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor, të ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2016 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar me Ligjin Nr. 49/2016, neni 801 e vijues të Ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr. 391 datë 21.06.2006, të ndryshuar me V.K.M 1064 datë 22.12.2010 "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave", VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë të Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive", VKM-së Nr.434, datë 08.06.2016 "Për disa ndryshime ne vendimin nr. 1353 date 10.10.2008 per percaktimin e rregullave paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik, si dhe te kritereve e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor", VKM se 435 date 08.06.2016 "Per disa ndryshime ne Vendimin nr 1374 date 10.10.2008 Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqien, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e te miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Shkreses Nr.2859/3 Prot, datë 02.05.2017 nga Ministria e Mjedisit "Për hartim te raportit tekniko-ekonomik, urdherit te Kryetarit te Bashkise Maliq Nr. 149/1 date 08.05.2017 "Per hartimin e raportit tekniko-ekonomik per ndertimin e Hec Gorice nga shoqeria The Blue Star", Urdherit te Ministrit te Mjedisit Nr. 207 date 13.06.2017 "Per vijimin e procedurave per heqien nga fondi pyjor dhe kullosor publik te nje siperfaqe prej 0.008 ha ne funksion te ndertimit te Hec Gorice nga shoqeria The Blue Star shpk ne Bashkine Maliq, lidhet kjo kontratë qiraje midis:

I.PALET

1.QIRADHËNËS: Bashkia Maliq ,e përfaqësuar nga Kryetari Z. Gëzim TOPÇIU, e cila në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiradhënësit"dhe kështu do të thirret më poshtë.

2.QIRAMARRËS: Shoqëria "THE BLUE STAR shpk" regjistruar si person juridik në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me Nr. NIPT J73721019U, datë 10.03.1997 me seli në Drenove, Mborje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

NIPT J73721019U THE BLUE STAR SHPK Cel:0694901601 KORÇË-ALBANIA

ne hyrje te fshatit Mborje, Korce, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori Z. Andrea Miço, i cili në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiramarrësit"dhe keshtu do te thirret me poshte.
Sa më sipër Palët bien dakord si më poshtë:

II.DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qënë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontratë, palët bien dakort si vijon:

1. Kushtet paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake ashtu si dhe Shtojcat janë pjesë të kësaj kontrate .

2. Përcaktime

- Qiradhënësi është pronar përdorues i pasurisë së paluajtshme të kësaj kategorie me sipërfaqen prej 0.881 ha nga te cilat 0.873 ha eshte siperfaqe ne perdorim dhe 0.008 ha eshte siperfaqe qe hiqet nga fondi pyjor , e ndodhur në keto ngastra:
  - 18a, 22a, 31b, 32d, 33d, 42, 43 - te Ekonomise Pyjore "Bofje-Dushar 1".
- Rrugë Kalimi/E Drejta e Kalimit: Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim aktualisht është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, e administruar nga qiradhënësi, do te mirëmbahet dhe do ti shërbejë subjektit.

NENI 1
OBJEKTI I KONTRATËS

1. Objekti i kësaj kontratë është dhënia me qira subjektit "THE BLUE STAR shpk "(Ndertim Hec Gorice), për përdorim dhe heqje sipërfaqen prej 0.881 ha. nga te cilat 0.873 ha me një gjatësi prej 2.91 km që eshte siperfaqe ne perdorim për shtrirje tubacioni/kanal, si dhe sipërfaqes prej 0.008 ha qe hiqet nga fondi pyjor, me qellim " Ndertimin e Godines dhe Veprat e Marrjes", e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, ekonomia pyjore Bofje Dushar 1 eshte në administrim të Bashkisë Maliq ", në perputhje me raportit teknik-ekonomik dhe të Agjensisë së Pyjeve dhe Kullotave, me keto kufizime dhe koordinata:

Kufizimet	Kordinatat:X_____ Y_____
Veri_____	X_____ Y_____
Jug	X_____ Y_____
Lindje_____	X _____ Y_____
Perendim_____,	

2. Qiradhenesi i jep gjithashtu subjektit " THE BLUE STAR shpk ", per perdorim edhe siperfaqen prej 0 m² per rruge kalimi /e drejte kalimi ,per te bere te mundshem kalimin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA MALIQ

nga rruga kryesore per ne siperfaqen e marre ne perdorim per gjithe kohezgjatjen e kesaj kontrate, nepermjet pasurise se paluajtshme ne administrim te Qiradhenesit, qe nga moment i nenshkrimit te kesaj Kontrate.

3. Vendodhja e siperfaqes se dhene ne perdorim dhe rruga hyrese tregohen ne harten bashkengjitur kesaj kontrate si Shtojca 1.

NENI 2
QELLIMI

1. Kjo kontratë ka për qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate për ushtrimin e verpimtarise per tubacion/kanal dhe infrastruktures per ndertimin e Godines dhe veprave ujembledhese, në Njësinë Administrative Moglica, Bashkia Maliq.
2. Përdorimi i sipërfaqes do të kryhet vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave prane Bashkise Maliq për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë si dhe në Lejen e Mjedisit.

NENI 3
AFATI I KONTRATËS

1. Kjo Kontrate Qiraje me qiradhënësin Bashinë Maliq lidhet për një afat 10 (dhjete) vjecar duke filluar nga data 13.06.2017 deri në datën 13.06.2027, me të drejtë ripërtëritje cdo vit.
2. Për efekt të pagimit të vlerës vjetore dhe për të pasqyruar ndryshimet që ndodhin në legjislacion, kontrata rinovohet cdo vit .

NENI 4
VLERA VJETORE E QIRASË

1. Vlera totale e qirasë vjetore, e detajuar në Aneksin A, është në shumën prej 604 306 leke e cila konsiston ne :

a) **Vlera e perdorimit leke/ha/vit .**

Trungishte _____ha x _____ leke = _____ leke

Cungishte _____ha x _____ leke = _____ leke

Shkurre _____ha x _____ leke = _____ leke

Kullote _____ha x _____ leke = _____ leke

Inproduktive _____ha x _____ leke = _____ leke

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

a/1) Vlera e perdorimit per linjat gjatesore per Tubacion/Kanal ne km

Trungishte 0.780 km x 175 000 leke = 136500 leke

Cungishte _____km x _____ leke = _____ leke

Shkurre _____km x _____ leke = _____ leke

Kullote 2.030 km x 145000 leke = 294350 leke

Inproduktive/Djerr 0.100 km x 110000 leke = 11000 leke

Vlera e perdorimit per tubacion/kanal = **441850 leke**

a/2) Vlera e perdorimit per linjat gjatesore per Rruge Ndilimese ne km

Trungishte ___km x ___ leke = ___ leke

Cungishte __km x _ leke = ___ leke

Shkurre __km x leke = ____ leke

Kullote _____ km x _____ leke = _____ leke

Inproduktive/Djerr km x leke = leke

Vlera e perdorimit per tubacion/kanal = leke

b) Vleren e bimesise pyjore,flores dhe faunes leke e perbere nga :

1. Vlera e lendes se punimit 152239 leke
2. Vlera e druve te rjarrit 3941 leke
3. Vlera e prodhimeve te dyta pyjore 3000 leke
4. Kullotja 977 leke
5. Vlera e faunes 2300 leke
6. Vlera e investimeve te kryera (pyllezime,zevendesime,permiresime etj) leke
7. Te tjera _____ leke
8. Vlera e bimesise pyjore – 162457 leke

Gjithsej vlera e kontratës është 604 306 lekë/vit per vitin e pare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALLAKASTËR

NENI 5
PAGESA DHE REGJIMI I SAJ

1. Pagesa e qirasë do të bëhet cdo vit sipas kushteve të kësaj Kontrate
2. Pagesa e parë do të bëhet ditën e nënshkrimi të Kontratës nga Palet.
3. Cdo pagesë tjetër e përvitshme do të kryhet brenda 10 ditëshit të parë të muajit Qershor të viteve pasardhës.
4. Vlera e qirasë është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM Nr.391 , datë 21.06 2006, të ndryshuar me V.K.M 1064 datë 22.12.2010 "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave"
5. Qiraja do të paguhet për Bashkinë Maliq në llogarinë bankare të Bashkisë të mbajtur pranë bankes_____ , ose ne cdo llogari tjeter bankare te cilen Qiradhenesi do të njoftojë me shkrim qiramarrësin.
6. Në rast se qiramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, Qiradhënësi perfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për cdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% të vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatë vonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 3 dhe 5 të kësaj kontrate.

NENI 6
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

1. Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundesine qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
2. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës
3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vleren e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
4. Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr në dorëzim sipërfaqen pas rehabilitimit.
5. Qiradhënësi nuk përgjigjet për detyrimet kontraktore të kësaj kontrate kur shfaqen rrethanat e mëposhtme :
   - Sipërfaqes i del pronari privat që ka vendimin e organit shtetëror për kthimin e pronës së paluajtshme.
   - Sipërfaqja i nënshtrohet një përdorimi tjetër me Vendim të KKT sipas pikës 4 të nenit 19 të ligjit nr.9385 date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA MALIQ

- Sipërfaqja përfshihet në zona me përparësi zhvillimi turizmi sipas pikes 4 të nenit 19 te ligjit Nr.9385 date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.

NENI 7
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi " ka ta drejtë që per të punesuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra paisje dhe materiale te tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohëshme ose të përhershme, si dhe punime të tjera në përputhje me kërkesat e planit te rehabilitimit te siperfaqes objekt perdorimi dhe kushteve të Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.
2. Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
3. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë apo t'ja kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
4. Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
5. Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
6. Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në perputhje me dispozitat e Ligjit 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar.
7. Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Ministrise se Mjedisit dhe te bashkise të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim.
8. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
9. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 37 dhe 38 të ligjit 9385, date 04.05.2005 " Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.
10. Harton dhe miraton ne Agjencinë e Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Malig, planin e rehabilitimit dhe ndjek zbatimin e tij.

NENI 8
PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Në rast se Qiradhënësi do të transferojë titullin e pronesise per sipërfaqen e dhënë në përdorim ose ndonjë pjesë të rrugës së kalimit Qiramarrësi ka të drejtën e parablerjes.

2. Qiramarrësi duhët të njoftojë Qiradhënësin nëse Qiramarrësi ka si synim të përdorë të drejtën e parablerjes ose jo, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita në të cilën Qiramarrësi ka marrë njoftimin me shkrim.
3. Qiradhënësi nuk do të lejojë Palë të tjera të ndërtojnë apo vendosë pajisje të tjera të ngjashme, në pronën e marrë me qira nga Qiramarrësi apo në afërsi të saj pa pelqimin paraprak të Qiramarrësit.
4. Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj,Qiramarrësi do të çmontoje dhe do të heqë të gjitha ndërtimet dhe do të dorëzoje sipërfaqen e marrë ,sic ishte në gjendjen fillestare, përvec konsumimit fizik normal, duke zbatuar planin e rehabilitimit.
5. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim në adresat:
6. Për Qiradhënësin : *Adresa: Bulevardi "Rinia" Bashkia Maliq*

Për Qiramarrësin : Subjekti : "THE BLUE STAR shpk", Korce, Drenove Mborje ne hyrje te fshatit Mborje.

Neni 9
FORCA MADHORE

Në rast se ndonjëra nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore .
Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forces Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10
ZGJIDHJA E KONTRATES

Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit të kontrates.
Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të kërkesave të Lejes Mjedisore si dhe për rastet e pikes 4 të nenit 5 të kësaj kontrate për sipërfaqen e dhënë në përdorim nga Qiradhënësi
Njoftimi për zgjidhjen e njëanëshme të kontratës bëhët me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara zgjidhjes se saj.

DISPOZITA E FUNDIT

Për çështje që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil qe trajtojnë Kontratën e Qirasë, neni 801 e vijues i këtij Kodi.

Në rast mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Korcë.

Cdo korrigjim i kontratës pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

THE BLUE STAR

Kontrata hartohet me vullnetin e lirë të palëve, në gjuhën shqipe dhe të gjitha të nënshkruara nga të dyja palët dhe me efekte ligjore të njëjta, në katër kopje origjinale, nga një për secilën palë, një kopje dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Mjedisit dhe një kopje qëndron në arkivin e Bashkisë Maliq.

Sa më sipër lexohet kjo kontratë me përmbajtjen e të cilës palët janë plotësisht dakord dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruan atë rregullisht para meje dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALËT :

QIRADHËNESI :	QIRAMARRËSI:
BASHKIA MALIQ	SUBJEKTI TIIE BLUE STAR sh.p.k
KRYETARI	ADMINISTRATOR
Gëzim TOPÇIU	Andrea MIÇO

NOTERE

DENADA KODRA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr. 2003/1 Prot

Maliq, më 19.12.2024

KONTRATË QIRAJE

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

Baza Ligjore e Kontratës: Ligji Nr. 139. 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 801 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", Ligji 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" të ndryshuar, me VKM Nr.. 559 datë 29.07.2022 "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave", VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë të Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Maliq nr. 580 datë, 21.11.2024 "Për hartimin e Raportit tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit që preket nga aktiviteti i HEC Lozhan të Shoqërisë "ABV-Konstruksion" Shpk",

Lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet palëve:

I.PALET

1. **QIRADHËNËS: Bashkia Maliq,** e përfaqësuar nga Kryetari Z. Gëzim TOPÇIU, e cila në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiradhënësit "dhe kështu do të thirret më poshtë.

2. **QIRAMARRËS: Shoqëria "ABV-KONSTRUKSION" sh.p.k**, regjistruar si person juridik me NIPT: L52928803G, me seli në Kavajë, me adresë: Lagjja nr.3, Shëtitorja "Josif Budo", pallati nr. 2390, Zonë Kadastrale 8551, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori z. Agim Velaj, i cila në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiramarrësit "dhe kështu do te thirret me poshtë.

Sa më sipër Palët bien dakord si më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

II.DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontratë, palët bien dakord si vijon:

1. **Kushtet paraprake dhe Shtojcat**

Kushtet paraprake as dhe Shtojcat janë pjesë të kësaj kontrate .

2. **Përcaktime**

- Sipërfaqe përdorimi: Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar.
- Rrugë kalimi/E drejta e Kalimit: Rruga nga rruga kryesore për të hyrë në sipërfaqen e marrë në përdorim aktualisht është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, e administruar nga qiradhënësi, dhe do ti shërbejë shoqërisë H.K HEC Grabova 2 shpk .
- Qiradhënës: autoriteti shtetëror Bashkia Maliq që zotëron të drejtën e përdorimit e përgjigjet për menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullosor;
- Qiramarrës: Shoqëria "ABV-KONSTRUKSION" sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori z. Arlind Veliu.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1. Qiradhënësi i jep me qira për përdorim Qiramarrësit sipërfaqen me gjatësi **0.42 km** (kanal ekzistues), e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, në ngastrën **nr. 81.a**, **Ekonomia Pyjore Maliq-Lozhan**, në administrim të Bashkisë Maliq.

NENI 2

QELLIMI

1. Kjo kontratë ka për qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, të cilën qiradhënësi do e përdori në funksion të HEC-Lozhan. dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë .

NENI 3

AFATI I KONTRATËS

1. Afati i dhënies në përdorim është për periudhën deri në **10** (*dhjetë*) vjet, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
2. Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila Palë duhet të njoftojë Palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës për të njëjtën periudh ose për përfundimin e saj.
3. Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

NENI 4

VLERA VJETORE E QIRASË

1. **Vlera totale e qerasë vjetore** është në shumen prej **60,900 lekë**, e cila konsiston në :

a/2) Vlera e përdorimit për Kanal në km

Cungishtë 0,42 km x 145,000 lekë = 60,900 lekë

NENI 5

PAGESA DHE REGJIMI I SAJ

1. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo vit sipas kushteve të kësaj Kontrate.
2. Pagesa e parë do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimi të Kontratës nga Palët dhe në vitet pasardhëse do të kryhet në datën/muajin/vitin pasardhës së pagesës së vitit të parë.
3. Vlera e qirasë është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr.559 , datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".
4. Qiraja do të paguhet për Bashkinë Maliq në Degën e Thesarit Korçë, në llogarinë bankare të bashkisë me nr. Kodi 2168001 dhe nr. Llog. 0504030812 , ose ne çdo llogari tjetër bankare te cilën Qiradhënësi do të njoftojë me shkrim qiramarrësin.
5. Në rast se qiramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% të vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatë-vonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 2 të kësaj kontrate.

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

1. Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundësinë qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
2. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

4. Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr në dorëzim sipërfaqen pas rehabilitimit.
5. Qiradhënësi nuk përgjigjet për detyrimet kontraktore të kësaj kontrate kur shfaqen rrethanat e mëposhtme :
   - Sipërfaqes i del pronari privat që ka vendimin e organit shtetëror për kthimin e pronës së paluajtshme.
   - Sipërfaqja i nënshtrohet një përdorimi tjetër me Vendim të KKT sipas pikës 3 të nenit 24 të Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet".
6. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes se detyrimeve kontraktore midis palëve .

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi " ka ta drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohshme ose të përhershme.
2. Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
3. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nën kontraktime me subjekte të tjerë apo t'jua kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
4. Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim.
5. Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
6. Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar.
7. Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit dhe te Bashkisë të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim.
8. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MAMUR

9. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar .

NENI 8

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, Qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen, për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.
2. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim në adresat:
3. **Për Qiradhënësin : Bashkia Maliq,** *Adresa: Bulevardi "Rinia" Bashkia Maliq.*
   Për Qiramarrësin : Shoqëria "ABV-KONSTRUKSION" sh.p.k, regjistruar si person juridik me NIPT: L52928803G, me seli në Kavajë, me adresë: Lagjja nr.3, Shëtitorja "Josif Budo", pallati nr. 2390, Zonë Kadastrale 8551.

NENI 9

FORCA MADHORE

3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe kushtet e Lejes Mjedisore si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
4. Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr në dorëzim sipërfaqen pas rehabilitimit.
5. Qiradhënësi nuk përgjigjet për detyrimet kontraktore të kesaj kontrate kur shfaqen rrethanat e mëposhtme :
   - Sipërfaqes i del pronari privat që ka vendimin e organit shtetëror për kthimin e pronës së paluajtshme.
   - Sipërfaqja i nënshtrohet një përdorimi tjetër me Vendim të KKT sipas pikës 4 të nenit 19 të ligjit nr.9385 date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.
   - Sipërfaqja përfshihet në zona me përparësi zhvillimi turizmi sipas pikes 4 të nenit 19 te ligjit Nr.9385 date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

ENERGJI - VALAMARA Shpk L54615003D

NENI 7
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi " ka ta drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra paisje dhe materiale të tjera brënda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohëshme ose të përhershme, si dhe punime të tjera në përputhje me kërkesat e planit te rehabilitimit te siperfaqes objekt perdorimi dhe kushteve të Lejes Mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të saj.
2. Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
3. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë apo t'ja kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
4. Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.
5. Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
6. Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në perputhje me dispozitat e Ligjit 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar.
7. Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Ministrise se Mjedisit dhe te bashkise të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim
8. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
9. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme te kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 37 dhe 38 të ligjit 9385, datë 04.05.2005 " Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.
10. Harton dhe miraton ne Agjencinë e Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Maliq, planin e rehabilitimit dhe ndjek zbatimin e tij.

NENI 8
PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Në rast se Qiradhënësi do të transferojë titullin e pronësisë për sipërfaqën e dhënë në përdorim ose ndonjë pjesë të rrugës së kalimit Qiramarrësi ka të drejtën e parablerjes

ENERGJIA VALAMARA Osmani Sh.p.k L54615003D Gorë - Korçë - Shqipëri

2. Qiramarrësi duhët të njoftojë Qiradhënësin nëse Qiramarrësi ka si synim të përdorë të drejtën e parablerjes ose jo, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data në të cilën Qiramarrësi ka marrë njoftimin me shkrim.
3. Qiradhënësi nuk do të lejojë Palë të tjera të ndërtojnë apo vendosë pajisje të tjera të ngjashme, në pronën e marrë me qira nga Qiramarrësi apo në afërsi të saj pa pelqimin paraprak të Qiramarrësit.
4. Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj,Qiramarrësi do të çmontojë dhe do të heqë të gjitha ndërtimet dhe do të dorëzoje sipërfaqen e marrë ,sic ishte në gjendjen fillestare, përvec konsumimit fizik normal, duke zbatuar planin e rehabilitimit.
5. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim në adresat:
6. **Për Qiradhënësin :** *Adresa: Bulevardi "Rinia" Bashkia Maliq*

Për Qiramarrësin · Subjekti : "**Energjia Valamara shpk**", me seli në Fshatin Lozhan i Ri, Njesia administrative Gorë, ZK 2494, Maliq.

Neni 9
FORCA MADHORE

Në rast se ndonjëra nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rjedhin nga Forca Madhore .
Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forces Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Neni 10
ZGJIDHJA E KONTRATES

Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit të kontrates.
Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të kërkesave të Lejes Mjedisore si dhe për rastet e pikes 4 të nenit 5 të kësaj kontrate për sipërfaqen e dhënë në përdorim nga Qiradhënësi.
Njoftimi për zgjidhjen e njëanëshme të kontratës bëhët me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara zgjidhjes se saj

DISPOZITA E FUNDIT

Për çështje që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë Kontratën e Qirase, neni 801 e vijues i këtij Kodi.

Në rast mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Korcë.

ENERGJIA VALAMARA Shpk Shqipëri

Cdo korrigjim i kontratës, pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.

Kontrata hartohet me vullnetin e lirë të palëve, në gjuhën shqipe dhe të gjitha të nënshkruara nga të dyja palët dhe me efekte ligjore të njëjta, në katër kopje origjinale, nga një për secilën palë, një kopje dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Mjedisit dhe një kopje qëndron në arkivin e Bashkisë Maliq.

Sa më sipër lexohet kjo kontratë me përmbajtjen e të cilës, palët janë plotësisht dakord dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruan atë rregullisht para meje dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALËT :

QIRADHËNESI :

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Gëzim TOPÇIU

QIRAMARRËSI:

SUBJEKTI
ENERGJIA VALAMARA sh.p.k
ADMINISTRATOR

Mustafa OSMANI

NOTERE

DENADA KODRA

ENERGJIA VALAMARA
L34615003D
Korçë - Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr. 5351 Prot

Maliq, më 07.10.2025

KONTRATË QIRAJE

PËR

DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

Baza Ligjore e Kontratës: Ligji Nr. 139. 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 801 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", Ligji 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" të ndryshuar, me VKM Nr.. 559 datë 29.07.2022 "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave", VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë të Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Maliq nr. 274 datë, 05.06.2025 "Për hartimin e Raportit tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor që preket nga aktiviteti i HEC Verba të Shoqërisë Hydro Power Plant of Korça"sh.p.k.

Lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet palëve:

I.PALET

1. **QIRADHËNËS: Bashkia Maliq,** e përfaqësuar nga Kryetari Z. Gëzim TOPÇIU, e cila në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiradhënësit "dhe kështu do të thirret më poshtë.

2. **QIRAMARRËS: Shoqëria "Hydro Power Plant of Korça"**, regjistruar si person juridik me NIPT: K81830009N, me seli në Njësia Bashkiake nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", pallati " Palma e Arte", kati I-rë, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht nga Administratori z. Roberto Donzelli, i cila në këtë kontratë është në cilësinë e "Qiramarrësit "dhe kështu do të thirret më poshtë.

Sa më sipër Palët bien dakord si më poshtë:

HYDRO POWER PLANT OF KORÇA S.H.P.K. TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

II.DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Duke qenë se ekzistojnë kushtet paraprake, të cilat përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontratë, palët bien dakord si vijon:

1. **Kushtet paraprake dhe Shtojcat**

Kushtet paraprake ashtu si dhe Shtojcat janë pjesë të kësaj kontrate .

2. **Përcaktime**

- Sipërfaqe përdorimi: Vendi në të cilën do të ushtrohet veprimtaria për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të saj, të miratuar.
- Qiradhënës: autoriteti shtetëror Bashkia Maliq që zotëron të drejtën e përdorimit e përgjigjet për menaxhimin e administrimin e fondit pyjor/kullosor;
- Qiramarrës: Shoqëria Hydro Power Plant of Korça, përfaqësuar nga Administratori z. Roberto Donzelli.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

1. Qiradhënësi i jep me qira për përdorim Qiramarrësit sipërfaqen me gjatësi **3.76 km (kanal)**, e cila është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik të Bashkisë Maliq, në ngastrat:

Ekonomia Pyjore	Ngastra	Kanal
		Gjatësia në përdorim (km)
EP Mesmal	8a	0.25
EP Mesmal	10b	0.44
EP Mesmal	10e	0.06
EP Mesmal	74j	0.38
EP Strelce	94b	0.52
EP Strelce	95a	0.14
EP Strelce	95b	0.18
EP Strelce	95d	0.07
EP Strelce	96a	0.55
EP Strelce	96c	0.17
EP Strelce	97b	0.19
EP Strelce	100b	0.55
EP Strelce	101b	0.26
SHUMA		**3.76**

NENI 2

QELLIMI

1. Kjo kontratë ka për qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, të cilën qiradhënësi do e përdori në funksion të HEC-Verba. dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë .

NENI 3

AFATI I KONTRATËS

1. Afati i dhënies në përdorim është për periudhën deri në **10** (*dhjetë*) vjet, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
2. Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila Palë duhet të njoftojë Palën tjetër për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës për të njëjtën periudh ose për përfundimin e saj.
3. Në mungesë të këtij njoftimi ose të ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

NENI 4

VLERA VJETORE E QIRASË

1. **Vlera totale e qerasë vjetore** është në shumen prej **616 300 lekë.**, e cila konsiston në :

a/2) Vlera e përdorimit për Kanal në km

Trungishte	2.37 km	x 175 000 lekë	= 414 750	lekë
Cungishte	0,52 km	x 145 000 lekë	= 75 400	lekë
Shkurre	0.57 km	x 145 000 lekë	= 82 650	lekë
Kullotë	0.3 km	x 145 000 lekë	= 43 500	lekë
Inproduktive	____ km	x ____ lekë	= ____	lekë
Toke me Bimësi Pyjore/Djerr	____ km	x ____ lekë	= __	lekë

Vlera totale e përdorimit për kanal = **616300 lekë**

NENI 5

PAGESA DHE REGJIMI I SAJ

1. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo vit sipas kushteve të kësaj Kontrate.
2. Pagesa e parë do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimi të Kontratës nga Palët dhe në vitet pasardhëse do të kryhet në datën/muajin/vitin pasardhës së pagesës së vitit të parë.

HYDRO POWER PLANT OF KORÇA Sh.P.K. TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

3. Vlera e qirasë është e pandryshueshme. Ajo do të ndryshojë vetëm nëse do të ketë ndryshime të aktit nënligjor VKM nr.559 , datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".
4. Qiraja do të paguhet për Bashkinë Maliq në Degën e Thesarit Korçë, në llogarinë bankare të bashkisë me nr. Kodi 2168001 dhe nr. Llog. 0504030812 , ose ne çdo llogari tjetër bankare te cilën Qiradhënësi do të njoftojë me shkrim qiramarrësin.
5. Në rast se qiramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, Qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% të vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatë-vonesave do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 2 të kësaj kontrate.

NENI 6
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

1. Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon qiramarrësit mundësinë qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.
2. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.
3. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata, si dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
4. Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr në dorëzim sipërfaqen pas rehabilitimit.
5. Qiradhënësi nuk përgjigjet për detyrimet kontraktore të kësaj kontrate kur shfaqen rrethanat e mëposhtme :
   - Sipërfaqes i del pronari privat që ka vendimin e organit shtetëror për kthimin e pronës së paluajtshme.
   - Sipërfaqja i nënshtrohet një përdorimi tjetër me Vendim të KKT sipas pikës 3 të nenit 24 të Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet".

HYDRO POWER PLANT OF KORÇA sh.p.k. TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

6. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes se detyrimeve kontraktore midis palëve .

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate "Qiramarrësi " ka ta drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm, të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj kontrate; të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij; të transportojë mallra pajisje dhe materiale të tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira; të bëjë ndërtime të përkohshme ose të përhershme.
2. Qiramarrësi nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, të tretëve, pa marrë më parë miratimin nga Qiradhënësi për ushtrimin e veprimtarisë.
3. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nën kontraktime me subjekte të tjerë apo t'jua kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
4. Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim.
5. Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj kontrate.
6. Qiramarrësi të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar.
7. Qiramarrësi të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit dhe te Bashkisë të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim.
8. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.
9. Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen kërkesat e Ligji Nr. 57/2020 "Për Pyjet", dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar .

HYDRO POWER PLANT OF KOKËZA SHPK TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MA

NENI 8

PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. Në fund të periudhës së kësaj kontrate ose në përfundim të saj, Qiramarrësi do të rehabilitojë sipërfaqen, për çdo dëmtim që mund të jetë shkaktuar gjatë veprimtarisë dhe do ta dorëzojë sipërfaqen e marrë, siç ishte në gjendjen fillestare, përveç konsumimit fizik normal.
2. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim në adresat:
3. **Për Qiradhënësin : Bashkia Maliq,** *Adresa: Bulevardi "Rinia" Bashkia Maliq.*

   Për Qiramarrësin : **Shoqëria Hydro Power Plant of Korça** regjistruar si person juridik me NIPT: K81830009N, me seli në Njësia Bashkiake nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", pallati " Palma e Arte", kati I-rë, Tiranë.

NENI 9

FORCA MADHORE

Në rast se ndonjëra nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mos përmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore .

Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

NENI 10

ZGJIDHJA E KONTRATES

Kontrata zgjidhet me marrëveshje midis palëve si dhe me mbarimin e afatit të kontratës.

Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të mos kryerjes së pagesës së qirasë.

Njoftimi për zgjidhjen e njëanshme të kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes së saj.

Kontrata bëhet e pavlefshme kur është e pa shoqëruar me hartën përkatëse të gjeoreferuar me koordinatat përkatëse.

Kontrata zgjidhet menjëherë kur sipërfaqia e dhënë në përdorim kërkohet për interesa publike të miratuara nga A.K.P.T.

HYDRO POWER PLANT OF KORÇA SH.P.K. TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

NENI 11

DISPOZITA E FUNDIT

Për çështje që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë Kontratën e Qirasë, neni 801 e vijues i këtij Kodi.

Në rast mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Kjo kontratë qiraje u formulua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga të cilat 1 (një) e merr Qiramarrësi dhe 2 (dy) i merr Qiradhënësi.

Sa më sipër lexohet kjo kontratë me përmbajtjen e të cilës palët janë plotësisht dakord dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruan atë rregullisht.

PALËT :

QIRAMARRËSI
Hydro Power Plant of Korça
ADMINISTRATORI
Roberto Donzelli

QIRADHËNESI
BASHKIA MALIQ
KRYETARI
Gëzim TOPÇIU

BASHKIA M/
Zyra e Proto
Nr.3153/1 Prot.....
Date 13.10.25 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE

Nr. 359 prot. Tiranë, më 20.10.2025

Lënda: Kthim përgjigje mbi hartat e planit të mbarështimit.

BASHKISË MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq

Për dijeni:

KËSHILLIT BASHKIAK
BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq

MALIQ

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr. 3153 Prot, me lëndë "Mbi hartat e planeve të mbarështimit", ju bëjmë me dije si vijon:

Duke parë problematikën e ngritur edhe nga Këshilli Bashkiak i bashkisë tuaj, Ministria e Mjedisit më përputhje me procedurat administrative ka ngritur grupin e punës, për të kryer verifikimin e pretenduar në terren.

Në praninë e përfaqësuesve të strukturës përgjegjëse për pyjet të bashkisë Maliq, të përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq dhe të përfaqësuesve të fshatit Velçan, u krye verifikimi në terren, duke u mbështetur në gjurmimin e trupit ujor dhe duke marrë koordinata gjeografike pozicionuese të tij.

Koordinatat gjeografike janë marrë nga pajisja GPS-Garmin 64, me saktësi gabimi standart në matje ± 3 m. Koordinatat gjeografike janë mbajtur shënim pikë pas pike nga të gjithë përfaqësuesit e pranishëm dhe verifikimi i tyre mund të bëhët nga hartat bashkëlidhur kësaj shkrese.

Pas përfundimit të punës në terren, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) i është drejtuar kompanisë ABCONS, për të marrë formatin origjinal "shapefile" të hartave të ekonomisë pyjore Mesmal. Kompani ABCONS, me shkresën Nr. 2025-AKB-068, ka përcjellë në drejtim të MTM hartat digjitale të ekonomisë pyjore Mesmal në formatim "shapefile".

Me administrimin e të dhënave nga MTM, formati digjital i hartës së bashku me koordinatat gjeografike të marra në terren, është përcjellë në drejtim të dy studiove që kanë ekspertizë në fushën e Sistemit Gjeografik të Informacionit (GIS), nga ku është kërkuar që të pozicionohen në hartë të dhënat e marra në terren.

Nga këqyrja e hartave të punuara, rezulton që gjurma e trupit ujor të pasqyruar në hartat e gjendjes eksistuese të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Mesmal, të mos përputhet me atë reale të matur në terren. Kjo provon në mënyrë të pakontestueshme pretendimet e banorëve të zonës, të ngritura si tematikë problematike në Këshillin Bashkiak.

Për sa më sipër, struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë Maliq, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbështetur në provat dhe argumentet e mësipërme, të kryejnë ndryshimin në sistemin ALFIS dhe të bashkëlidhin fragmentin e korigjuar në hartat e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Mesmal.
Bashkëlidhur gjeni hartat me legjendat përkatëse për të kryer korigjimet dhe përditësimet e nevojshme në sistemin ALFIS.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E MJEDISIT

gjende

- Pika GPS ne aks te lumit
- Kufiri i Ekonomise Pyjore
- Rrjedhje
- Parcela pyjore
- Landcover

Pozicionimi ne harten tematike te Ekonomise pyjore Mesmal te pikave te matura ne terren me GPS..

Matjet jane kryher ne terren me aparature GPS te saktesise se larte me daten 24.07.2025 ne aks te lumit. Matjet u kryhen ne prezence te perfaqesuesve te bashkise Maliq, anetareve te keshillit bashkiak dhe banoreve te fshatitVelcan.

Koordinatat ne sistemin Wgs84 UTM

Nr. Pikës	Lindje	Veri	Lartësia (m)
001 VEL	463,987.00	4,513,453.00	835.00
002 VEL	463,988.00	4,513,424.00	833.00
003 VEL	464,002.00	4,513,388.00	832.00
004 VEL	463,949.00	4,513,360.00	831.00
005 VEL	463,924.00	4,513,350.00	831.00
006 VEL	463,891.00	4,513,345.00	831.00
007 VEL	463,901.00	4,513,337.00	828.00
008 VEL	463,942.00	4,513,278.00	827.00
009 VEL	463,936.00	4,513,241.00	823.00
0010 VEL	463,898.00	4,513,217.00	821.00
0011 VEL	463,877.00	4,513,219.00	819.00
0012 VEL	463,831.00	4,513,224.00	819.00
0013 VEL	463,784.00	4,513,223.00	819.00
0014 VEL	463,735.00	4,513,214.00	816.00
0015 VEL	463,712.00	4,513,166.00	816.00
0016 VEL	463,721.00	4,513,122.00	813.00
0017 VEL	463,708.00	4,513,091.00	813.00
0018 VEL	463,674.00	4,513,076.00	813.00
0019 VEL	463,643.00	4,513,061.00	815.00
0020 VEL	463,632.00	4,513,062.00	819.00
0021 VEL	463,609.00	4,513,061.00	820.00
0022 VEL	463,560.00	4,513,051.00	815.00
0023 VEL	463,516.00	4,513,027.00	813.00
0024 VEL	463,488.00	4,512,983.00	814.00
0025 VEL	463,472.00	4,512,957.00	817.00
0026 VEL	463,437.00	4,512,940.00	818.00
0027 VEL	463,396.00	4,512,926.00	818.00
0028 VEL	463,360.00	4,512,905.00	816.00
0029 VEL	463,323.00	4,512,861.00	809.00
0030 VEL	463,303.00	4,512,817.00	809.00
0031 VEL	463,286.00	4,512,798.00	809.00
0032 VEL	463,269.00	4,512,766.00	809.00
0033 VEL	463,259.00	4,512,744.00	809
0034 VEL	463,264.00	4,512,731.00	809.00
0035 VEL	463,257.00	4,512,712.00	809.00
0036 VEL	463,238.00	4,512,679.00	809.00
0037 VEL	463,241.00	4,512,662.00	809.00
0038 VEL	463,244.00	4,512,646.00	809.00
0039 VEL	463,246.00	4,512,636.00	809.00
0040 VEL	463,250.00	4,512,619.00	813.00
0041 VEL	463,226.00	4,512,567.00	817.00
0042 VEL	463,207.00	4,512,550.00	814.00
0043 VEL	463,190.00	4,512,525.00	815.00
0044 VEL	463,181.00	4,512,492.00	814.00
0045 VEL	463,118.00	4,512,456.00	814.00
0046 VEL	463,095.00	4,512,435.00	814.00
0047 VEL	463,055.00	4,512,055.00	815.00
0048 VEL	463,029.00	4,512,016.00	803.00
0049 VEL	462,990.00	4,511,998.00	802.00
0050 VEL	462,944.00	4,511,937.00	796.00



Grupi i punes qe realizoi matjet ne terrren:
Ylli Hoxha
Admir Seci
Klarsen Braho
Petrika Theodhosi
Andi Sulo

Prezent:
Ylson Ibraimllari
Eglantina Shkembi

HARTA E PARAQITJES SË TRUPËS UJORE NGA MATJET NË TERREN



E	N	Z	Nr.
463987	4513453	835	1
463986	4513424	833	2
464002	4513388	832	3
463949	4513360	831	4
463924	4513350	831	5
463891	4513345	831	6
463901	4513337	828	7
463942	4513278	827	8
463936	4513241	823	9
463898	4513217	821	10
463877	4513219	819	11
463831	4513224	819	12
463784	4513223	819	13
463735	4513214	816	14
463712	4513166	815	15
463731	4513122	813	16
463708	4513091	813	17
463674	4513076	813	18
463648	4513061	815	19
463632	4513062	816	20
463609	4513061	820	21
463560	4513051	815	22
463536	4513027	813	23
463488	4512983	814	24
463422	4512957	817	25
463437	4512940	818	26
463396	4512926	816	27
463360	4512905	816	28
463328	4512861	809	29
463303	4512817	809	30
463288	4512798	809	31
463269	4512766	809	32
463259	4512744	809	33
463264	4512731	809	34
463257	4512712	809	35
463238	4512679	809	36
463241	4512662	809	37
463244	4512646	809	38
463246	4512636	809	39
463250	4512619	813	40
463226	4512567	817	41
463207	4512550	814	42
463190	4512525	815	43
463161	4512492	814	44
463118	4512456	814	45
463095	4512435	814	46
463055	4512055	815	47
463029	4512016	803	48
462990	4511998	802	49
462944	4511937	796	50

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 5852 Prot Maliq, më 03 .11 .2025

VENDIM
Nr.131 datë 31.10.2025

Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.37 datë 28.05.2021 për miratimin e një ndryshimi në sistemin ALFIS të ekonomisë pyjore Mesmal.

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.2 germa b; Ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 28.05.2021 "*Për miratimin paraprak të Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Maliq*"; Urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Maliq-Lozhan, Mesmal, Moglicë, Pirg-Moçan, Bofje Dushar, Zëmblak Mali i Thatë dhe Strelcë, Bashkia Maliq*": Shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve me nr. 354 prot. datë 10/ 10 / 2025 :

VENDOSI:

1. Të miratoj ndryshimin në sistemin ALFIS të fragmentit të korrigjuar në hartat e planit të mbarështrimit të ekonomisë pyjore Mesmal.
2. Bazuar në verifikimin e bërë në terren nga specialistë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe propozimit të bërë prej tyre, struktura përgjegjëse për pyjet në bashki në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve mbështetur në provat dhe argumentimin e dhënë në shkresë me nr. 354, datë 10.10.2025 të kryejnë ndryshimin në sistemin ALFIS duke bashkëlidhur fragmentin e korrigjuar në hartat e planit të mbarështrimit të ekonomisë pyjore Mesmal .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në bashki për të ndjekur gjithë procedurat e ndryshimit prej Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Miratuar me 20 vota
Vota pro 20
Vota kundër 0
Vota apstenim 0
Zbardhur më datë 03.11.2025

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr. 5652/2 Prot.
Date 20.10.25 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 1041 Prot.

Korçë, më 28.11.2025

Lënda : Mbi bazueshmërinë ligjore të aktit të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, pas verifikimit të vendimit nr. 131, datë 31.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Maliq, ***konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij,*** bazuar në nenet 3, 8, 9, 27, 54, 55, dhe 64 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 3 pikat 4 dhe 5, nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar, në pikën 36 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive", i ndryshuar, në urdhrin e Ministrit të Turizimit dhe Mjedisit nr. 299, date 04.10.2022 për "Miratimin e Planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Maliq-Lozhan, Mesmal, Moglicë, Pirg-Moçan, Bofje, Dushar, Zëmblak-Mali i Thatë dhe Strelcë, Bashkia Maliq", si dhe në shkresën nr. 354, prot., datë 10.10.2025 të Ministrisë së Mjedisit, drejtuar Bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë Maliq, "Mbi hartat e planit të mbarështimit".

PREFEKTI
NERTIL JOLE

REPUBLIKA E SHQIPERISE - PREFEKTI I QARKUT KORCE

Adresa: Lagja. 7 Rr. "28 Nëntori", e-mail: Prefekti.Korce@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 3153/2 Prot.

Maliq më, 24/12/2025

Lënda: Për hartën e Planit të mbarështimit Mesmal.

AGJENCISË KOMBËTARE TË PYJEVE
SEKTORIT TË KADASTRËS DHE PLANEVE TË MBARËSHTIMIT
Rruga "Halit Bega", Godina Nr.181, Kati III, Allias, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Mjedisit nr. 354 datë 10.10.2025 protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3153/1 prot datë 13.10.2025 me lëndë "Kthim përgjigje mbi hartat e planit të mbarështimit" mbi problematikën e ngritur të gjurmës së trupit ujor lumi i Velçanit po ju dërgojmë bashkëngjitur shkresën nga Ministria e Mjedisit, Drejtoria e natyrës dhe pyjeve me nr. 354 prot datë 10.10.2025 së bashku me dy harta të pasqyrimit të gjurmës së lumit, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 131 datë 31.10.2025 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 37 datë 28.05.2021 për miratimin e një ndryshimi në sistemin ALFIS të ekonomisë pyjore Mesmal" dhe shkresë nga Prefekti i Qarkut Korçë nr. 1041/1 prot datë 18.11.2025 "Mbi bazueshmërinë ligjore të aktit të Këshillit". Në bazë të shkresës nr. 354 prot datë 10.10.2025 të Ministrisë së Mjedisit "*Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Maliq, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbështetur në provat dhe argumentet e mësipërme, të kryejnë ndryshimin në sistemin ALFIS dhe të bashkëlidhin fragmentin e korrigjuar në hartat e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Mesmal*".

Faleminderit .

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 746 Prot. Maliq më, 10 / 2 /2026

Lënda: Kthim përgjigje.

MINISTRISË SË MJEDISIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIMIN E MJEDISIT
DREJTORIA E NATYRËS DHE PYJEVE
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.1, 1001, Tiranë.

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 353 prot datë 10.10.2025 protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr. 3153/1 prot datë 13.10.2025 ju bëjmë me dije se praktikën e dërguar nga ju, Bashkia Maliq ja ka përcjellë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve me shkresë nr.3153/2 prot. datë 24.12.2025.
Agjencia Kombëtare e pyjeve ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 135 prot datë 28.01.2026, në të cilën shprehet se:
"*Veprimet e kryera në hartën e Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Mesmal sjellin ndryshime në gjendjen e fondit pyjor, përfshirë treguesit silvoteknikë, pronësinë, administrimin dhe kategorinë e përdorimit të tokës.*
Përsa më sipër Bashkia Maliq të reflektojë korrigjimin e kufinjve dhe ndryshimet që rrjedhin nga ky korrigjim në PM dhe të ndjekë procedurën e miratimit të këtyre ndryshimeve sipas përcaktimeve të nenit 11".
Në këto kushte sipas kërkesës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve kërkojmë dërgimin e hartave të gjurmës së lumit Velçan, të nënshkruara dhe vulosura duke pasqyruar në këto harta edhe ndryshimin e kufijve nëse ka.
Bashkëngjitur po ju dërgojmë përgjigjen e dërguar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.
Faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT
DREJTORIA E BIODIVERSITETIT

Nr. 908/1 Prot. Datë 5.3.2026

Lënda: Mbi kërkesën për ndryshim kufiri të ekonomisë pyjore "Mesmal"

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 746/1 Prot.
Date 09.03.26 Nënshkrimi

Z. Gëzim TOPÇIU
Kryetar
BASHKIA MALIQ
Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

I nderuar Z. Kryetar,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.746, datë 10.02.2026 "Kthim përgjigje", drejtuar Ministrisë së Mjedisit, ju bëjmë me dije se:

Sipas shkronjës (c), pika 3, e nenit 11, të ligjit 57/202 "Për pyjet", i ndryshuar, planet e mbarështimit për pyjet rishikohen apo përditësohen, sipas nevojës, nga strukturat përgjegjëse të parashikuara në këtë ligj dhe ndjekin të njëjtin proces miratimi, si plan i ri mbarështimi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

- S. Pyje-kullota
dt 09.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

6217/1.

Z. Yllson Ibrahimllari
Maliq





REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA BAŞHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA BAŞHKIA MALIQ